

VENDIM
Nr. 656, datë 7.8.2013

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE PËR SHPENZIME KORENTE, NDËRMJET
PROGRAMEVE TË MIRATUARA PËR MINISTRINË E PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE
SHANSEVE TË BARABARTA, NË BUXHETIN E VITIT 2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve për shpenzime korente, ndërmjet programeve të miratuara për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, brenda buxhetit të vitit 2013, si më poshtë vijon:

a) Programit “Mbrojtja sociale”, tit. 10 430, kap. 1, art. 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”, t’i shtohet fondi 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë.

b) Programit “Tregu i punës”, tit. 10 550, kap. 1, art. 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”, t’i pakësohet fondi 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha